



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Doracak

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi

Prishtinë, 2014

Përmbajtja

Hyrje	3
Qëllimi i Doracakut	3
1. Roli i KKSB-ve në promovimin e sigurisë në bashkësi	4
2. Dokumentet strategjike që adresojnë sigurinë në bashkësi	7
3. Themelimi dhe përbërja e KKSB-së	8
4. Procedura për themelimin e KKSB-së	9
4.1. Si zgjedhën në KKSB përfaqësuesit e OJQ-ve, medieve lokale, komunitetit të biznesit dhe përfaqësuesve të personave me aftësi të kufizuara	10
5. Objektivat e KKSB-së në çështjet e sigurisë	11
6. Detyrat e KKSB-së	12
6.1. Përgatitja e Planit vjetor të punës	13
6.2. Identifikimi i problemeve dhe rekomandimi i planeve të veprimit	14
6.3. Bashkëpunimi me policinë	16
6.3.1. Bashkëpunimi me forumet e sigurisë	18
6.4. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi	19
6.5. Paraqitja e kërkesave në Kuvendin e Komunës për financimin e projekteve për siguri në bashkësi	20
7. Mbledhjet e KKSB-së	20
8. Monitorimi i KKSB-ve	21
8.1. Monitorimi i brendshëm	21
8.2. Monitorimi i jashtëm	22
9. MBIKQËYRJA DHE RAPORTET	22
Shtojca 1	23
Lista me iniciativat/projektet për siguri në bashkësi të parashtruara nga anëtarët e këshillit komunal për siguri në bashkësi për planin vjetor të punës për vitin ..XXXX	23
Shtojca 2	23
Plani vjetor i punës për këshillin komunal për siguri në bashkësi për vitin ... XXXX	23
Shtojca 3	24
Forma unike për përpilimin e raportit nga takimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së)	24
Shtojca 4	26
Praktika ndërkombëtare të Këshillave për Siguri në Bashkësisë	26

Hyrje

Doracaku për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi është pjesë e dokumenteve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe Grupit Drejtues për Zbatimin e Strategjisë për Siguri në Bashkësi. Ky doracak do t'iu shërbej komunave, përkatësisht KKSB-ve për zbatimin e dispozitave ligjore dhe për të zhvilluar politikat lokale me ndikim në sferën e sigurisë në bashkësi. Doracaku mund të përdoret në kuptimin e një udhërrëfyes për zhvillimin e kapaciteteve në komuna në identifikimin dhe adresimin e problemeve që ndërlidhen me sigurinë në bashkësi.

Përmes këtij Doracaku synojmë të rrisim vetëdijen e institucioneve dhe akterëve të tjerë në fushën e sigurisë në bashkësi, për forcimin e instrumenteve të kontrollit formal dhe joformal shoqëror për të krijuar një ambient të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët. Doracaku mund të përdoret si udhëzues praktik për komunat dhe partnerët tjerë për sigurimin e zbatimit të dispozitave të akteve ligjore dhe nënligjore për funksionimin e KKSB-ve dhe arritjen e objektivave themelore për sigurinë në bashkësi.

Qëllimi i Doracakut

Qëllimi parësor i këtij Doracaku është të shërbej si mjet reference për komunat dhe partnerët e angazhuar për ndërmarrjen e veprimeve për funksionalizimin e KKSB-ve, si dhe krijimin e një ambienti të sigurt përmes parandalimit, reduktimit dhe kufizimit të faktorëve social dhe mjedisor që ndikojnë në sigurinë në bashkësi.

Dokumenti synon të vejë në pah se ekzistojnë politika efektive në nivelin lokal dhe veprime përmes së cilave mund të reduktohen sjelljet deviante në shoqëri, ngritet niveli i sigurisë dhe të nxiten qytetarët për të bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse për siguri.

Doracaku sqaron rëndësinë e konceptit të sigurisë në bashkësi, policimit në bashkësi, rolin dhe përgjegjësitë e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi, procedurat e themelimit të KKSB-së, objektivat, si dhe detyrat e anëtarëve të KKSB-së.

Përmes këtij Doracaku, lexuesi do të jetë në gjendje të kuptoj:

- Rolin dhe rëndësinë e KKSB-së lidhur me mbështetjen e sigurisë në bashkësi;
- Objektivat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të KKSB-së;
- Mënyrën e funksionimit të KKSB-së

- Si mund të adresojë KKSB-ja çështje lidhur me sigurinë në bashkësi;
- Sa ka qenë i suksesshëm kontributi i KKSB-së në sigurinë në bashkësi në Kosovë;
- Praktika ndërkombëtare (ose struktura të ngjashme) sa i përket KKSB-së;

1. Roli i KKSB-ve në promovimin e sigurisë në bashkësi

Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi janë themeluar në vitin 2009 në të gjithë Kosovën me vizion të përmirësimit të sigurisë dhe stabilitetit në bashkësi. Struktura e tyre përfshin një gamë të gjerë akterësh ndër-sektorial, të cilët luajnë një rol afatgjatë të rritjes së sigurisë në bashkësi. KKSB-ja ka një qasje të gjerë në ofrimin e sigurisë si dhe përgjegjësve për ofrimin e një mjedisi të sigurt. Për këtë arsye, siguria e qytetarëve të Kosovës është përgjegjësi jo vetëm e Policisë së Kosovës, por edhe strukturave qeveritare të nivelit qendror dhe lokale si dhe shoqërisë civile. KKSB-ja siguron një forum të veçantë për t'i bashkuar në një vend këto grupe të interesit. Për të pasur bashkësi të sigurt, të gjitha palët e interesuara duhet të angazhohen në mënyrë aktive në identifikimin e problemeve, mbledhjen, analizimin e të dhënave dhe gjetjen e zgjidhjeve.

Për më shumë, KKSB duhet të përqendrohet në gjetjen e shkaqeve rrënjësore të faktorëve destabilizues në bashkësi. Parandalimi i dukurive negative duhet të përqendrohet edhe në të ardhmen dhe ka të bëjë me zvogëlimin e rrezikut të shfaqur dhe seriozitetit të mundshëm të krimit dhe ngjarjeve shqetësuese për bashkësinë. Me qëllim të mbështetjes së parandalimit të krimit dhe sigurimit të prosperitetit në bashkësi, KKSB-ja kërkon nga zyrtarët përgjegjës të sigurisë, të punojnë me përfaqësuesit e shoqërisë civile si dhe zyrtarët qeveritar në nivel qendror dhe lokal, për të zbatuar politikën e qeverisjes së mirë. Ky koncept në shumë vende të botës njihet si "policimi në bashkësi". Siç është përshkruar nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë, policimi në bashkësi", promovon zhvillimin e strategjive që mbështesin partneritetin sistematik dhe teknikat e përshtatshme për zgjidhjen e problemeve, si dhe trajton në mënyrë proaktive rrethanat e menjëhershme që promovojnë çështjet e sigurisë siç janë: krimi, frika nga krimi, çrregullimi social apo fenomene të tjera që mund të ndikojnë në jetën dhe prosperitetin e qytetarëve. KKSB-ja mbështet një qasje jo-tradicionale dhe gjithëpërfshirëse për sigurinë në bashkësi dhe parandalimin e krimit dhe dukurive të tjera negative.

Meqë KKSB-të janë funksionalizuar, parimet udhëzuese të përcaktuara nga Zyra e Kombeve të Bashkuara duhet të mbeten në krye të aktiviteteve të Këshillit¹, si vijon:

¹http://ëëë.unodc.org/pdf/criminal_justice/UN_standards_and_norms_in_crime_prevention_at_your_finger_tips.pdf

- **Lidership konstruktiv qeveritar:** Është i nevojshëm për krijimin dhe zbatimin e kornizave institucionale për mbështetjen e sigurisë në bashkësi dhe zbatimin e politikave;
- **Zhvillimi dhe përfshirja socio-ekonomike:** Nevojat lidhur me parandalimin e krimit duhet të integrohen në të gjitha politikat relevante sociale dhe ekonomike;
- **Bashkëpunimi/partneriteti:** Duhet të jetë pjesë integrale e parandalimit efektiv të krimit, duke pasur parasysh natyrën e gjerë të shkaqeve të krimit si dhe aftësitë dhe përgjegjësitë e nevojshme për trajtim të tyre;
- **Qëndrueshmëria/përgjegjësia:** Duhet të vihen në dispozicion burime të mjaftueshme për të mbështetur sigurinë në bashkësi me strukturat llogaridhënëse për të siguruar zbatim, vlerësim dhe arritje të rezultateve;
- **Njohuria bazike:** Siguria në bashkësi bazohet në një themel të shumë-disiplinor të njohurive sa i përket problemeve të krimit, shkaqeve të shumta të tyre dhe praktikave të vërtetuara të ndërhyrjes;
- **Të drejtat e njeriut/sundimi i ligjit/kultura e ligjshmërisë:** Këshilli duhet të mbështesë të drejtat dhe idealet e normave ndërkombëtare për sundim të ligjit dhe ligjshmërisë;
- **Ndërvarësia:** Strategjitë e sigurisë në bashkësi duhet të njohin lidhjen e faktorëve destabilizues me mjedisin e jashtëm duke përfshirë edhe komunat apo shtetet tjera si dhe të veprohet në përputhje me rrethanat;
- **Dallimi:** Duhet të merren parasysh nevojat e ndryshme të bashkësisë, veçanërisht në lidhje me gjininë, të drejtat e pakicave apo qytetarëve me aftësi të kufizuara.

Disa nga veprat kryesore negative destabilizuese që ndikojnë në sigurinë e bashkësisë në Kosovë janë:

Vjedhja e veturave	Plaçkitja	Sulmi seksual	Dhuna në familje
Aksidente në komunikacion	Përdorimi i drogës	Mungesa e sigurisë në shkollë	Ekstremizmi i dhunshëm
Mjedisi fizik	Vetëvrasja	Qentë endacak	Cenimi i shëndetit publik

Megjithatë, statistikave dhe prioritetet e secilës komunë dallojnë. Roli i KKSB-së është të identifikojë sfidat kryesore në bashkësi dhe më pas të propozojë një zgjidhje të përshtatshme apo ndërhyrje që mund të kryhet në nivel komunal.

1.1 Sa mund të jetë i suksesshëm kontributi i KKSB-së për sigurinë në bashkësi në Kosovë

Deri më tani, KKSB-të janë themeluar në të gjitha komunat e Kosovës. Përfitimet janë të dukshme edhe pse janë themeluar së fundi. Sa më shumë që të zhvillohen Këshillat aq më shumë do të shihen rezultatet në të gjitha komunat dhe komunitetet në tërësi. Më poshtë janë disa shembuj të problemeve të cilat mund të paraqiten në komuna të ndryshme për sigurinë në bashkësi dhe të ngriten si shqetësime nga KKSB:

<u>Bashkësia</u>	<u>Temat e mbuluara</u>	<u>Rezultatet</u>
Veri	<ul style="list-style-type: none"> - Veprat penale kundër pasurisë - Rrahjet për motive pasurore, - Përdorimi i armëve nëpër ahengje - Siguria në komunikacion - Zjarret - Qentë endacak - Përdorimi i narkotikëve nga të rinjtë - Mbeturinat në rrugë 	<ul style="list-style-type: none"> - Ndërmarrja e veprimeve policore, shtim i kontrolleve të policisë, konfiskimi i armëve - Patrullimi i policisë, kontrolli i automjeteve - Gatishmëri më e madhe e njësitit të zjarrfikësve - Sterilizimi dhe kastrimi i qenve - Bashkëpunimi me qytetarë - Prioritet më i madh por të vetëdijesuar të rinjtë nga dukuritë negative - Vendosja e shportave nëpër rrugë, angazhim më i madh i kompanisë së kontraktuar, përmbushja e detyrimeve të pagesave për mbeturina nga qytetarët
Lindje	<ul style="list-style-type: none"> - Vjedhjet - Vjedhje e metaleve - Siguria në trafik - Siguria në shkolla - Ndriçimi publik - Statistikat e përgjithshme të krimin - Kalim ilegal i kufirit 	<ul style="list-style-type: none"> - Inkurajimi i qytetarëve për të bashkëpunuar me policinë, informimi i menjëhershëm i rasteve - Observimi i shtuar i hekurishteve dhe personave të dyshuar nga policia - Numër më i madh i gjobave të shqiptuara - Caktimi i zyrtarëve policor me rroba civile në shkolla; Themelimi i Këshillit për parandalim të dukurive negative në shkolla në përbërje të: sociologëve, psikologëve, mjekëve, pedagogëve etj.; - Ndriçimi i rrugëve publike, pranë stacioneve të autobusëve dhe rrugëve me frekuentim më të madh të nxënësve - Masa të shtuara të sigurisë - Menaxhimi i integruar i kufirit
	<ul style="list-style-type: none"> - Aksidentet në trafik - Parandalimi i zjarreve - Lëmoshë-kërkuesit - Prishja e qetësisë publike 	<ul style="list-style-type: none"> - Aplikim më i madh i gjobave në trafik - Aktivizim i shtuar i njësitit të zjarrfikësve për shuarjen e zjarreve pas korrjeshirjeve dhe ndërmarrja e masave parandaluese; Përmirësimi i pajisjeve të shërbimit të zjarrfikësve; rritja e numrit të zjarrfikësve; bashkëpunimi me FSK

Qendër	<ul style="list-style-type: none"> - nga lokalet e natës - Mungesa e parkingjeve në qytet - Mungesa e transportit për zonat rurale 	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i Planit operativ për largimin e lëmosh-kërkuesve dhe ndërmarrja e masave për evitimin e dukurisë së lëmoshës - Themelimi i KLSP-së së lagjeve; adresimi i ankesave nga qytetarët në polici përmes KLSP-së lidhur me zhurmën; informimi i inspektionit komunal; ndërmarrja e masave nga inspektioni komunal për të evituar këtë problem - Ndërmarrja e veprimeve nga komuna për rregullimin e vend-parkingjeve në qytet - Shqyrtimi i çështjes në Drejtorinë për Shërbime Publike; Sigurimi dhe organizimi i transportit nga fshatrat deri në qytet dhe anasjelltas
Jug - perendim	<ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese - Vjedhja e pyjeve - Siguria e përgjithshme - Kontrabanda me narkotik 	<ul style="list-style-type: none"> - Prioritet i komunës për ndërtimin e trotuareve; ndihmesë nga policia në vendosjen e shenjave sinjalizuese - Bashkëpunim ndërmjet organeve komunale dhe policisë në parandalimin e vjedhjeve të pyjeve; rritja e përgjegjësisë së rojeve të pyjeve; vëzhgimi nga policia i vendeve të shitjes; - Shtim i patrullimit patrullimit në këmbë të policisë nëpër qytet;

2. Dokumentet strategjike që adresojnë sigurinë në bashkësi

Qeveria e Republikës së Kosovës ka hartuar kuadrin strategjik të sigurisë në nivel qendror. Qeveria ka miratuar dhe publikuar një numër të strategjive, nga të cilat duhet të veçojmë²:

1. Strategjia Nacionale dhe Planin e Veprimit për Sigurinë në Bashkësi 2011-2016
2. Strategjinë Nacionale kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore
3. Strategjinë Shtetërore për Parandalim të Krimit
4. Strategjinë kundër Drogave, Terrorizmit, Krimit të Organizuar, Migracionit dhe Strategjinë për Siguri Nacionale.
5. Strategjia e Policimit në Bashkësi dhe Plani i Veprimit 2012-2016

² Strategjia Nacionale dhe Planin e Veprimit për Sigurinë në Bashkësi 2011-2016, fq 17

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Strategjisë për Sigurinë në Bashkësi 2011-2016 siguron bashkërendimin me strategjitë tjera dhe që mundëson krijimin e partneriteteve komunale dhe zbatimin e objektivave nacionale në fushën e sigurisë nga niveli lokal.

3. Themelimi dhe përbërja e KKSB-së

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) është kategori kushtetuese i përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe themelohet në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Çdo komunë është e obliguar të themelojë Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. KKSB themelohet me vendim të Kuvendit të komunës dhe kryesohet nga Kryetari i Komunës. Në rast të mungesës së kryetarit, KKSB kryesohet nga nënkryetari i komunës përkatëse.

Mandati i KKSB-së është 4 vite dhe korresponon me periudhën e mandatit të Kuvendit të Komunës.

Në çdo komunë, kryetari i komunës duhet të caktoj një zyrtar përgjegjës për administrimin e punëve të KKSB-së (Koordinatorin).

KKSB përbëhet nga:

1. "Kryetari i Komunës
2. Komandanti i Stacionit të Policisë në komunën përkatëse
3. Një përfaqësues i secilës bashkësi fetare të komunës përkatëse;
4. Një përfaqësues i secilit komunitet etnik të komunës përkatëse
5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete në komunë
6. Zyrtari për Barazi Gjinore
7. Drejtori i Drejtoratit për Arsim
8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës përkatëse
9. Një përfaqësues i FSK-së
10. Një përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike
11. Kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi
12. Një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale
13. Një përfaqësues i OJQ-ve
14. Përfaqësuesi i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim

15. Një përfaqësues i medieve lokale

16. Një përfaqësues i komunitetit të biznesit dhe

17. Një përfaqësues i komunitetit të personave me aftësi të kufizuara (PAK)³.

Në vijim është paraqitur struktura organizative e KKSB-së:




Fig.1. Struktura organizative e KKSB-së.

4. Procedura për themelimin e KKSB-së

Në pajtim me rregullat e Udhëzimit Administrativ për KKSB, kryetari i komunës duhet të ndërmarr hapat vijues:

1. Brenda 30 ditëve nga fillimi i mandatit të ri të rregullt të kryetarit të komunës, “kryetari i komunës përmes mjeteve të informimit publik, fton komunitetet përkatëse për të bërë propozimet e anëtarëve të tyre në KKSB”⁴.

³ Udhëzimi Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, neni 4.

⁴ Po aty, neni 9, paragrafi 1.1

2. “Në rast se ndonjë komunitet etnik nuk propozon përfaqësuesin e vet për anëtar të KKSB-së, atëherë kryetari i komunës në konsultim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim propozon anëtarin nga komuniteti përkatës në KKSB”⁵.
3. Pas marrjes së propozimeve, kryetari i komunës përgatit listën e anëtarëve të KKSB-së sipas përbërjes së nenit 4 të U.A. për KKSB dhe të njëjtën listë e dërgon për miratim në Kuvendin e Komunës⁶.
4. KKSB konsiderohet se është themeluar pas miratimit të vendimit nga Kuvendi i Komunës.
5. Vendimi për themelimin e KKSB-së hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal brenda afatit prej 15 ditësh nga pranimi i tij dhe publikimit në faqen zyrtare elektronike të komunës⁷.




Fig.2. Procedura e themelimit të KKSB-së

4.1. Si zgjedhën në KKSB përfaqësuesit e OJQ-ve, medieve lokale, komunitetit të biznesit dhe përfaqësuesve të personave me aftësi të kufizuara

⁵ Po aty, neni 10, paragrafi 2

⁶ Po aty, neni 9, paragrafi 1.2

⁷ Rregullore Nr.01/2013 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, neni 18

Sipas përbërjes, KKSB ka edhe 1 anëtar tjetër që përfaqëson: OJQ-të, mediet lokale, komunitetin e biznesit dhe komunitetin e personave me aftësi të kufizuara Udhëzimi Administrativ për KKSB nuk përcakton mënyrën e selektimit të përfaqësuesve nga këto grupe të interesit, por në mënyrë të përgjithshme përshkruan të drejtën e kryetarit të komunës (kryesuesit të KKSB-së) për përgatitjen e listës së anëtarëve të KKSB-së sipas propozimeve të tyre.

Pas njoftimit të dërguar nga kryetari i komunës tek grupet e interesit, është përgjegjësi e OJQ-ve, medieve lokale, komuniteti i PAK dhe komuniteti i biznesit që në mënyrë të mëvetëshme të organizohen dhe të propozojnë përfaqësuesin më kompetent për KKSB.

Komuna mund të ofroj mundësinë, kushtet logjistike dhe hapësirat e nevojshme për të mbajtur një takim publik mes këtyre grupeve, në mënyrë që këto grupe të përzgjedhin përfaqësuesin e tyre.

Kriteret për përfaqësim duhet të përcaktohen nga komuna, sipas objektivave të përcaktuara me U.A. për KKSB. Përfaqësuesit e përzgjedhur duhet të kenë njohuri në fushën e vetëqeverisjes lokale dhe sigurisë në bashkësi.

5. Objektivat e KKSB-së në çështjet e sigurisë

Objektivat e KKSB-së janë formuluar për të dhënë përgjigje ndaj çështjeve të sigurisë që duhet adresuar. Sipas Udhëzimit Administrativ, KKSB ka 5 objektiva kryesore:

1. "Rritjen e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal;
2. Identifikimin e brengave lidhur me sigurinë publike;
3. Rekomandimin e planeve të veprimit dhe adresimi i brengave të qytetarëve te autoritetet komunale;
4. Ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi
5. Përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve për çështjet e krimit dhe çështjet e tjera që lidhen me kualitetin e jetës"⁸.

⁸ Udhëzimi Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, neni 5.

6. Detyrat e KKSBS-së



Përbërja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ofron mundësinë për adresimin e gjerë të problemeve me të cilat mund të përballen qytetarët e komunave. Përbërja e KKSBS-së, mundëson të trajtohen sferat e ndryshme të sigurisë në bashkësi dhe të adresohen problemet për t'u zgjidhur në institucionet përgjegjëse. Për shembull, siguria në shkolla është temë e cila mund të trajtohet në nivelin lokal përmes koordinimit të organeve të shkollës, prindërve, mësimdhënësve, drejtorisë për arsim në komunë, drejtorive komunale përkatëse, policisë dhe aktorëve të tjerë. Çdo përfaqësues (anëtar) i KKSBS-së duhet të paraqes dhe të jap ide, plane, propozime, sugjerime dhe projekte konkrete për fushën përkatëse të cilën mbulon dhe që ka të bëjë me ruajtjen apo përmirësimin e sigurisë në bashkësi.

Detyrat kryesore të KKSBS-së, ndër të tjera janë:

- 1- "Përgatitja e Planit vjetor të Punës
- 2- Identifikimi i problemeve dhe rekomandimi i planeve të veprimit
- 3- Bashkëpunimi me policinë
- 4- Bashkëpunimi me institucionet qendrore që merren me sigurinë publike
- 5- Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSBS-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi
- 6- Paraqitja e kërkesave në Kuvendin e Komunës për financimin e projekteve për siguri në bashkësi
- 7- Paraqitja e kërkesave në organizata të ndryshme për financimin e projekteve për siguri në bashkësi;
- 8- Të ftoj në takimet e KKSBS-së përfaqësuesit e MPB-së – DSB.

- 9- Të ftoj në takimet e KKSB-së përfaqësuesit e institucioneve qeveritare, medieve dhe shoqërisë civile
- 10- Të kërkoj nga policia përgjigje për rastet që kanë rëndësi në sigurinë publike.
- 11-Mbajtjen e takimeve të rregullta të KKSB-së”⁹.

6.1. Përgatitja e Planit vjetor të punës

Plani i punës së KKSB-së është dokument me të cilin përcaktohen objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSB-së në përmbushje të qëllimit funksionimit të KKSB-së. Një plan efektiv i punës do të merrte parasysh strategjitë komunale dhe shtetërore për përafrimin objektivave dhe burimeve (kapaciteti financiar dhe njerëzor). Për shembull, strategjitë e zhvillimit komunal apo planeve të veprimit për Integrim Evropian mund të përdoren si referencë për t'i ndërlidhur me prioritetet.

Planet e suksesshme të punës identifikojnë qëllime, aktivitete dhe rezultate të qarta dhe caktojnë përgjegjësitë për kryerjen e veprimeve konkrete. Një plan model pune është përfshirë si Shtojca 1 për referencë, mirëpo plani mund të ketë forma të ndryshme.

Procesi i hartimit të PVP-së është si në vijim:

1. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë dhe rishikimi i zbatimit të PVP-së
2. Mbledhja e iniciativave/projekteve/ propozimeve për PVP-në për vitin vijues nga anëtarët e KKSB-së nga përfaqësues të institucioneve shtetërore, grupe të interesit dhe diskutimet publike
3. Hartimi i draftit të PVP-së
4. Diskutimi dhe miratimi i draftit të PVP-së
5. Monitorimi dhe vlerësimi i PVP-së¹⁰.

Anëtarët e KKSB-së nuk duhet të kufizohen vetëm në detyrat e caktuara në Planin e Punës, por duhet të jenë më aktiv sidomos në përcjelljen e zhvillimeve të përditshme shoqërore, në mënyrë që t'i identifikojnë dhe t'i adresojnë kërkesat e qytetarëve. KKSB duhet të krijoj raporte të rregullta me Kuvendin e Komunës dhe të kërkoj në vazhdimësi mbështetje financiare për zbatimin e projekteve të sigurisë që derivojnë nga Planin e Punës apo nevojat që paraqiten.

⁹ Po aty, neni 6.

¹⁰ Republika e Kosovës, MPB: “Udhëzues për hartimin e Planit vjetor të punës për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi”, Qershor, 2013, fq.4.

6.2. Identifikimi i problemeve dhe rekomandimi i planeve të veprimit

Identifikimi i problemeve rreth sigurisë në bashkësi është njëra ndër detyrat kryesore të anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Zgjidhja e problemeve rreth sigurisë publike është çështje e cila u takon të gjithë pjesëmarrësve dhe institucioneve shtetërore. Shumë shqetësime për sigurinë në bashkësi janë të njohura nga aspekti i përgjithshëm, përfliten si dukuri nga se qytetarët janë të prekur nga to, mirëpo adresimi i tyre jo rrallë herë nuk është adekuat. Megjithatë, kur gjërat e caktuara shndërrohen në dukuri, atëherë nevojitet që problemi të trajtohet, adresohet në organet përgjegjëse, të identifikohen shkaqet dhe të krijohet mundësia për evitimin e tyre.

KKSB duhet të siguroj metoda dhe mjete të përshtatshme për krijimin e kontakteve të rregullta me qytetarë. Qytetarët duhet të jenë të informuar për ekzistimin e KKSB-ve dhe të kenë adresë të caktuar për të paraqitur brengat e tyre. Pa marrë parasysh se çfarë lloji i metode është përdorur,¹¹ qasja e promovimit të sigurisë përfundon në zbatimin e programeve të ndërhyrjes bazuar në një shumëllojshmëri të teknikave dhe metodave të tilla si; ndërhyrjet përmes medieve, publikimit të dhënave lokale, publikimin e opinioneve dhe seancave e këshillave trajnuese për akterët, duke mundësuar aktivitete për disa grupe të synuara, tryeza të sigurisë, si dhe vëzhgimin dhe zhvillimin e produkteve të caktuara

Është e domosdoshme që në kuadër të UEB-faqeve të komunave të integrohet linku për KKSB. Në kuadër të këtij linku është i nevojshëm aplikacioni për raportim të qytetarëve, ku qytetarët mund të postojnë informacionet lidhur me çështjet e sigurisë. Një hap i tillë krijon mundësinë për identifikimin më të lehtë të problemeve. Përveç kësaj, shfrytëzimi i mjeteve të informimit publik është mundësi e mirë për identifikimin e nevojave për përmirësimin e sigurisë së qytetarëve.




Fig.3. Mënyra e identifikimit dhe adresimit të problemeve në KKSBB

Shembulli 1. Problemi i orientuar në mjedis

Shembull praktik: Identifikimi i problemit në KKSB

Identifikimi i problemit nga ana e anëtarit të KKSB-së: Nxënësit janë në rrezik ndërsa ecin në këmbë për të shkuar në shkollë për shkak të infrastrukturës së dobët, sidomos, mungesës së trotuareve dhe vendkalimeve për këmbësorë.

Veprimi i KKSB-së: Një anëtar i KKSB-së mund ta adresojë çështjen në një takim të rregullt. Më pas Këshilli identifikon nëse çështja e adresuar është me prioritet, dhe nëse po, atëherë i identifikon ndërhyrjet e mundshme

Zgjidhja e propozuar: Gjetja e mjeteve financiare për zgjidhje të problemit nga institucionet përgjegjëse.

Ashtu siç është paraqitur në shembullin e mësipërm, qëllimi mobilizues i këtij procesi është një problem specifik, por që ka të bëjë me sigurinë e përgjithshme në një bashkësi. Objektivi është që të veprojnë në një sërë tregues mjedisorë dhe të sjelljes, më qëllim të përmirësimit të sigurisë së një bashkësie. Për një këshill të qytetit, i mandatuar për të siguruar të gjitha kushtet e sigurisë për popullatën, një qasje që është kryesisht “e orientuar në mjedis” do të ishte më e përshtatshme.

6.3. Bashkëpunimi me policinë

Policia e Kosovës ka rol kyç në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. KKSB është mekanizëm i duhur për ndërtimin e një besimi reciprok në mes qytetarëve dhe policisë. Përmes KKSB-së qytetarët e kanë më të lehtë që problemet e tyre t'i adresojnë në mënyrë më të organizuar. Prandaj, roli i Policisë së Kosovës në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit, është që të paraqes në Këshill shqetësimet kryesore të komunitetit lidhur me sigurinë në bashkësi. Gjithashtu, komandanti i stacionit policor në cilësinë e anëtarit të KKSB-së, duhet të shërbejë si një ndërlidhës për transmetim të përfundimeve të KKSB-së në Policinë e Kosovës në mënyrë që të inkorporohen në strategjinë e tyre të policimit. Sipas nevojës, PK-ja mund të ftojë përfaqësues të tjerë në mbledhjet e Këshillit për të dhënë informacione mbi tema të veçanta apo për të dëgjuar shqetësimet e anëtarëve të komunitetit.

Me qëllim të parandalimit dhe luftimit të kriminalitetit në Kosovë, Policia bashkëpunon me autoritetet e qeverisjes lokale, forumet e sigurisë, organizatat civile (OJQ-të), mediet, në të gjitha komunat dhe komunitetet në Kosovë¹². Në këtë drejtim, bashkëpunimi në mes të policisë dhe bashkësisë forcohet përmes: 1) Pjesëmarrja e rregullt e komandantit të stacionit policor apo të dërguarit të tij në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi dhe 2) Pjesëmarrja e komandantit të policisë apo të deleguarit të tij në Këshillin Komunal për Siguri Publike.

Bashkëpunimi ndikon në ndërtimin e besimit të qytetarëve tek organet e rendit, forcon ndjenjën e sigurisë në mjedisin ku jetojnë, u mundëson banorëve ambient të sigurt, siguron zbatimin e ligjit dhe bënë që qytetarët t'i paraqesin problemet tek policia.

Po ashtu, komunikimi dhe bashkëpunimi në mes kryetarit të komunës, drejtorive përkatëse, inspektionit të komunës dhe komandantit të stacionit të policisë dhe zyrtarëve të tjerë të policisë duhet të jetë i vazhdueshëm. Në këtë aspekt, shkëmbimi i informatave në mes tyre vetëm se rritë sigurinë e përgjithshme dhe krijon parakushte për ndërgjegjësimin e qytetarëve në raport me ruajtjen e të mirave publike.

Format e tjera të bashkëpunimit me policinë me qëllim të rritjes së sigurisë në bashkësi:

- Shkëmbimi i informatave rreth problemeve të sigurisë
- Konsultimi për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi.
- Takime të rregullta mes zyrtarëve të komunës dhe zyrtarëve policor.
- Pjesëmarrja e rregullt e zyrtarëve policor në takimet e KKSB-së;
- Bashkëpunimi me Këshillin Lokal për Siguri Publike
- Bashkëpunimi me Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi
- Prezenca e rregullt e policisë në zbatimin e masave të caktuara administrative nga organet komunale;
- Informimi për çështjet e sigurisë në bashkësi nga drejtori i policisë në Kuvendin e Komunës;

Përparësitë e bashkëpunimit:

- Krijim i kushteve për të punuar më lehtë dhe në kushtet të sigurisë më të lartë për të gjithë
- Policim më efektiv në bashkësi
- Më pak raste që do të përfundojnë në gjykatë;
- Promovim i respektit të ndërsjellët
- Rritje e efikasitetit të policisë
- Rritje e besimit në polici dhe zvogëlim i 'frikës' nga policia
- Komuniteti ndjehet më i sigurt.
- Më pak tensione dhe konflikte
- Forcohet komunikimi me policinë
- Siguria për fëmijët dhe të moshuarit është më e madhe
- Çrrenjosje më e shpejtë e krimit

¹² Udhëzim Administrativ Nr. 10/2012 "Bashkëpunimi policor me Kuvendin Komunal dhe Komunitetin", neni 7.

- Zbatimi i rekomandimeve të KKSB-së për aq sa mund të ndikoj policia;
- Zbatimi i rekomandimeve të policisë për çështjet e përmirësimit të sigurisë nga komuna për aq sa ka të bëjnë me kompetencat e komunës;
- Avancimi i komunikimit të këshillit të prindërve të shkollave me policinë;
- Fushatat vetëdijësuese për promovimin e KKSB-së;
- Informimi publik;
- Inkurajimi i bashkësisë për të identifikuar dhe adresuar pikëpamjet e veta në lidhje me shqetësimet, brengat, problemet dhe çështjet që kanë të bëjnë me kriminalitetin dhe zvogëlimin e frikës nga kriminaliteti;
- Mbështetjes dhe inkurajimit të iniciativave për siguri, me qëllim të parandalimit të kriminalitetit dhe bashkëpunim të qëndrueshëm;
- Pjesëmarrje në hartimin e projekteve për sigurimin e burimeve financiare për zbatimin dhe monitorimin e të gjitha iniciativave dhe aktiviteteve që kanë të bëjnë me sigurinë në bashkësi;

6.3.1. Bashkëpunimi me forumet e sigurisë

KKSB bashkëpunon edhe me Këshillat Lokale për Siguri Publike, Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi.

Komitetet Lokale për Siguri Publike - si një ndër forumet e sigurisë i përkasin nivelit bazë të hierarkisë së infrastrukturës për siguri në bashkësi të Kosovës. Ato përfshijnë numrin më të madh të njerëzve që përfaqësojnë bashkësinë në përgjithësi. KLSP përbëhet nga përfaqësuesit e të gjitha komuniteteve në lokacionin ku themelohet, duke i kushtuar rëndësi përfaqësimit gjinor, organizatave rinore, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës nga radhët e komuniteteve, bashkësive etnike, shoqërisë civile dhe anëtarëve të tjerë të bashkësive të qytetarëve të cilët reflektojnë diversitetin e komunitetit.

KLSP-të janë në gjendje për të trajtuar çështjet e sigurisë, të krimit, sigurisë dhe jetesës nga poshtë-lart përmes krijimit të partneriteteve pozitive dhe efektive, duke përdorur procesin e zgjidhjes së problemeve. Nëpërmjet kanaleve të hapura të komunikimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, KLSP-të e mbështesin punën e KKSB-ve.

Qëllimi i KLSP-ve është që t'u ofroj bashkësive lokale mundësinë e ngritjes së zërit në policimin e zonave të tyre, të jenë organe konsultative në fushën e krimit dhe sigurisë duke identifikuar çështjet me interes, zhvillimin dhe implementimin e projekteve efektive, për të adresuar këto çështje në nivel lokal, në një marrëdhënie të ngushtë pune me autoritetet komunale, bashkësitë lokale dhe policinë..

KLSP-të janë organe lokale konsultuese dhe këshilluese për komandantet e stacioneve, të cilët duhet të konsultojnë KLSP-të rreth nivelit të krimit dhe prishjes së rendit dhe qetësisë në zonën e tyre, në këtë mënyrë ata mbajnë ata të informuar dhe ne dijeni për çështjet e sigurisë lokale.

“KLSP është organ konsultues i cili do të duhej të jetë i informuar mbi natyrën dhe nivelin e krimit, trazirat dhe sjelljet e dhunshme, t’i njoh çështjet e sigurisë dhe t’i identifikoj metodat e zhvillimit dhe zbatimit të projekteve efektive si dhe planet e veprimit. KLSP-ja do t’i adresoj çështjet lokale të krimit, sigurisë së bashkësisë dhe kushteve jetësore të institucionet përkatëse.

Udhëheqësi i KLSP duhet të jetë anëtar i KKSB.

- **Bashkëpunimi me Ekipet Vepruese për Siguri Publike**

“EVSB-të” nënkuptojnë Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi të cilat përbëhen prej zyrtarëve komunalë, policëve dhe udhëheqësve të bashkësisë. Qëllimi i tyre primar është që të punojnë së bashku për identifikimin dhe adresimin e çështjeve të krimit, sigurisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.

EVSB-të themelohen pas aprovimit të programit nga ana e kryetarit të komunës dhe komandantit të stacionit gjegjës policor dhe formojnë Komitetin Rekrutues në nivel komunal.

Komandanti i stacionit gjegjës policor dhe zyrtarët policor të trajnuar si anëtar të EVSB-së, së bashku me anëtarë të EVSB-së mund të ndihmojnë në përpilimin dhe zbatimin e projekteve të sigurisë në bashkësi. “EVSB ka të drejtë të kërkoj nga kuvendi i komunës ose ndonjë organizatë qeveritare ose jo qeveritare mbështetjen e projekteve lidhur me sigurinë në bashkësi”¹³.

Një përfaqësues i Ekipave Vepruese për Siguri në Bashkësi duhet të jetë anëtar i KKSB-s.

6.4. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me KKSB-të e komunave fqinje për çështjet e sigurisë në bashkësi

Çështjet e sigurisë në bashkësi nganjëherë mund të varen nga bashkëveprimi i dy ose më shumë komunave. Kjo mund të vjen në shprehje sidomos në komunat të cilat kufizohen me njëra tjetrën dhe kështu nevojitet bashkëpunimi më i ngushtë mes tyre. KKSB e një komune, mund të rekomandojnë projekte konkrete për t’u realizuar në

¹³ Udhëzim Administrativ Nr. 10/2012 “Bashkëpunimi policor me Kuvendin Komunal dhe Komunitetin”, neni 6.5.

mënyrë të përbashkët me KKSB-të e komunave të tjera. Në këtë drejtim, KKSB mund të kërkojë nga kryetari i komunës që të ndërmerr nisma për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal për projektet që lidhen me sigurinë bashkësi dhe që janë në kompetencë të komunës. Të tilla nisma mund të bëhen për rregullimin e rrugëve lokale të cilat mund të lidhin dy komuna mes tyre të cilat lehtësojnë qarkullimin e njerëzve dhe automjeteve, apo të tilla si parandalimin e prerjes së pyjeve.

6.5. Paraqitja e kërkesave në Kuvendin e Komunës për financimin e projekteve për siguri në bashkësi

KKSB mund të kërkojë nga Kuvendi i Komunës financimin e projekteve të lidhura me sigurinë në bashkësi. Projekte të tilla mund të përfshijnë: ndriçimin publik, menaxhimin e mbeturinave, çështjet e inspektimit, ndërtimet pa leje, standardet e ndërtimit, mungesën infrastrukturës në shkolla, mungesën e transportit publik në vendbanime të ndryshme, problemin e qeneve endacakë, mungesën e ofrimit të shërbimit primar shëndetësor, mungesën e semaforëve, “policëve të shtrirë”, mungesën e kanalizimit në një lagje, nevojën për parqe publike, kontrollin e ushqimit, shëndetin publik etj.

Në rast se komuna në planet strategjike nuk ka përfshirë projekte që reflektojnë segmente të sigurisë në bashkësi, atëherë është detyrë e anëtarëve të KKSB-së të kërkojnë nga komuna përfshirjen e tyre në projeksionet buxhetore afatshkurtra dhe afatgjata. Është e rëndësishme që KKSB, gjatë hartimit të projekt-buxhetit të komunës për vitin pasues, të marr pjesë në diskutimet buxhetore dhe të parashtroj propozimet konkrete për projektet e sigurisë në bashkësi. Në këtë drejtim, kryesuesi i KKSB-së duhet të thërras takim të KKSB-së për të diskutuar për projektet e sigurisë në bashkësi, para miratimit të buxhetit të komunës.

Përveç kërkesës për ndarje buxhetore komunale, Këshilli mund të kërkojë financim të jashtëm nga donatorët nëpërmjet projekt-propozimeve. Propozimet e tilla duhet të koordinohet përmes kryetarit të komunës në mënyrë që të shmangen dublikimi me projektet e ngjashme komunale. Propozimet për grumbullimin e fondeve të jashtme duhet të përfshihen në planin vjetor të punës.

7. Mbledhjet e KKSB-së

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi mban jo më pakë se 6 takime në vit¹⁴, por nuk përjashtohet mundësia që të mblidhet edhe më shpesh, varësisht nga nevojat që dalin nga aktualiteti i kërkesave që paraqiten. Vendi ku ky Këshill mblidhet është ndërtesa e komunës, mirëpo në bazë pajtimit të shumicës së anëtarëve të KKSB-së, mbledhjet mund të mbahen edhe në ndonjë lokacion tjetër. Për çdo mbledhje mbahet procesverbali, i cili i duhet të jetë i disponueshëm për anëtarët e Kuvendit të Komunës, një kopje e të cilit i dërgohet edhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal¹⁵.

8. Monitorimi i KKSB-ve

Monitorimi i KKSB-ve është një proces i vazhdueshëm dhe dinamik. Ky proces nënkupton shtrirjen e mbikëqyrjes në punën e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi duke përfshirë monitorimin e mbledhjeve të KKSB-ve dhe realizimin e Planit vjetor të punës. Monitorimi rritë cilësinë e KKSB-ve dhe krijon mundësinë e përkrahjes së tyre duke marrë për bazë vlerësimin e punës së tyre, evidentimin e nevojave dhe vështirësive. Qëllimi i monitorimit është të mundësoj respektimin e ligjit nga organet komunale dhe të ofroj ndihmë në aspektin profesional. Po ashtu, shkëmbimi i rregullt i të dhënave, procesverbaleve dhe aktiviteteve, rritë cilësinë dhe saktësinë e informatave nga komunat. Një bashkëveprim i tillë do të mundësoj raporte më kualitative për punën e KKSB-ve, duke përfshirë: aktivitetet e ndërmarra nga pjesëmarrësit e KKSB-ve, projektet e propozuara, konkluzionet e nxjerra, zbatimin e rekomandimeve, sfidat dhe vështirësitë.

Monitorimi i KKSB-ve është proces i cili shtrihet përmes: monitorimit të brendshëm dhe monitorimit të jashtëm.

8.1. Monitorimi i brendshëm

Ky lloj i monitorimit të punës së KKSB-ve bëhet me qëllim të rritjes së efikasitetit të KKSB-ve dhe përmirësimit të zbatimit të planeve, iniciativave dhe projekteve për siguri në bashkësi. Kryesuesi i KKSB-së duhet të raportoj në KK dy herë në vit në lidhje me zbatimin e PVP-së, në pajtim me nenin 9, pikën 1.8 të UA-së për KKSB-të. Sipas kësaj, kryetari i komunës obligohet të informoj Kuvendin e Komunës dy herë brenda vitit në lidhje me aktivitetet e KKSB-së. Përveç kësaj, Koordinator i KKSB-së në koordinim me kryesuesin e KKSB-së duhet të organizojë rishikimin e PVP-së dy herë në vit gjatë takimeve të KKSB-së. Në këto takime do të raportohet për progresin e secilës iniciativë/projekti të sigurisë në bashkësi. Raportimi do bëhet nga anëtari i KKSB-së i cili është i ngarkuar me monitorimin e zbatimit të iniciativës apo nga përfaqësuesi i

¹⁴ Po aty, neni 11, paragrafi 2.

¹⁵ Po aty, neni 11 paragrafi 5 dhe 6.

autoritetit komunal i cili është ngarkuar për të zbatuar iniciativën/projektin. Vlerësimi i zbatimit të planit të veprimit të PVP-së duhet të bëhet dy herë brenda vitit¹⁶.

8.2. Monitorimi i jashtëm

Ky monitorim sigurohet nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Dy ministritë mund të marrin pjesë drejtpërdrejtë në mbledhjet e KKSB-vë me qëllim të monitorimit të punës së tyre. Qëllimi i monitorimit është që KKSB të jetë e aftë për të zbatuar detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Ministritë mund të kërkojnë çfarëdo informate që lidhet me funksionimin e KKSB-ve, duke përfshirë: aktet themeluese të KKSB-ve, çdo projekt apo iniciativë të propozuar, planin vjetor të punës dhe procesverbalet e takimeve.

Monitorimi i punës së KKSB-ve dhe përpilimi i raporteve periodike, krijon mundësinë për pasqyrimin e drejtë të punës së KKSB-ve, të bëjë krahasime mes KKSB-ve të ndryshme, t'i bënë ato më efikase në adresimin e nevojave, si dhe rris përgjegjësinë për zbatimin më efikas të aktiviteteve për sigurinë publike.

Monitorimi i KKSB-ve bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Divizioni për Siguri në Bashkësi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila ofron informata për MAPL-në për përgatitjen e raporteve periodike për punën e KKSB-ve.

9. MBIKQËYRJA DHE RAPORTET

Mbikëqyrjen e zbatimit të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, e bën Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

MAPL, përgatit raporte periodike mbi punën e KKSB-ve.

¹⁶ MPB, “Udhëzues për hartimin e Planit Vjetor të Punës për këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi”, Qershor, 2013, pka 7.

Shtojca 1

Lista me iniciativat/projektet për siguri në bashkësi të parashtruara nga anëtarët e këshillit komunal për siguri në bashkësi për planin vjetor të punës për vitin ..XXXX

Nr.	Emri i iniciativës/ projektit	Përshkrim i shkurtër i iniciativës/ projektit	Parashtruesi /parashtruesit	Ndërlidhja me planin e veprimit të strategjisë nacionale për siguri në bashkësi 2011 – 2016 (shënoni numrin e objektivit/aktivitetit)	Specifikat buxhetore, nëse veç janë të ditura
1					
2					
3					
X					
XX					

Shtojca 2.

Plani vjetor i punës për këshillin komunal për siguri në bashkësi për vitin ... XXXX

Nr.	Emri i iniciativës	Përshkrimi i iniciativës / projektit	Ndërlidhja me planin e veprimit të strategjisë nacionale për siguri në bashkësi 2011- 2016 (shënoni numrin e objektivit/aktivitetit)	Kërkesat buxhetore (në euro)	Afati kohor për zbatimin e iniciativës/projektit	Institucioni përgjegjës komunal	Anëtari nga KKSB-ja përgjegjës për monitorimin/ raportimin e zbatimit të iniciativës /projektit
1							
2							
3							
X							
XX							

Shtojca 3.

Forma unike për përpilimin e raportit nga takimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS-së)

Komuna: _____		Data: _____	
Numri i takimit për këtë vit: _____		Takim i rregullt <input type="checkbox"/>	Takim emergjent <input type="checkbox"/>
Numri total i anëtarëve të KKSBS-së sipas UA _____		Femra _____	Meshkuj _____
Numri i anëtarëve të KKSBS-së të pranishëm në takim _____			
A janë ftuar të gjithë anëtarët e KKSBS-së për të marrë pjesë në takim? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>			
- Nëse "Jo", ju lutem që të potenconi arsyen:			
A janë komunitetet jo shumicë të përfaqësuara në këtë takim? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>			
- Nëse "Jo", ju lutem që të potenconi arsyen:			
Pjesëmarrës të pranishëm në këtë takim përveç anëtarëve të KKSBS-së: Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>			
- Nëse "Po", ju lutem që të potenconi duke përfshirë organizatën të cilën e përfaqësojnë.			
A kryesohet takimi nga Kryetari i Komunës? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>			
- Nëse "Jo", ju lutem që në vijim të shkruani emrin dhe pozitën/titullin e kryesuesit:			
Procesverbali - njoftimi i takimit të KKSBS-së:			
Është publikuar në ueb faqen e komunës njoftimi për takimin e KKSBS-së: Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>			
Iu është përcjellë procesverbali anëtarëve të KKSBS-së: Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>			
Iu është përcjellë procesverbali Ministrisë së Punëve të Brendshme(MPB) dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal(MAPL): Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>			

A është mbajt takimi sipas temave të parapara në agjendë?

Po Jo

Temat e parapara në agjendë:

1/

2/

3/

4/

5/

- Nëse "Jo", ju lutem që në vijim të shkruani pse, dhe njëherë të i paraqitni temat për të cilat është diskutuar:

1/

2/

3/

4/

5/

Konkluzionet:

Raporti/Forma unike u përpilua nga:

Data: _____

Vërejtje:

Shtojca 4

Praktika ndërkombëtare të Këshillave për Siguri në Bashkësisë

Lokacioni	Emri i partneritetit	Anëtarët relevant	Qëllimi	Joformale / Formale
“Staffordshire”, Mbretëria e Bashkuar	<p>Komuniteti për Siguri në Bashkësi</p> <p>Ueb-faqja: http://ëëë.staffordshire.gov.uk/community/communitysafety/home.aspx</p>	<p>Forca lokale policore, këshillat lokale, zjarrfikësit, grupet klinike të autorizimit dhe shërbimet e lirit me kusht</p>	<p>Zhvillimi dhe zbatimi i strategjive për të mbrojtur komunitetet lokale nga krimi, të ndihmohen njerëzit që të ndjehen të sigurt. Zhvillimi i qasjeve lokale për t'u marrë me çështje, duke përfshirë sjelljen e pamatur, abuzimi me drogë apo alkool dhe përsëritja e krimit</p>	Formale
Oakland, CA ShBA	<p>Këshillat për parandalim të krimit në lagje</p> <p>Ueb-faqja: https://sites.google.com/site/oaklandbeat22x/</p>	<p>Zyrtarët policor, shoqëria civile, përfaqësuesit e lagjeve</p>	<p>Zhvillimi i strategjive për të identifikuar sjelljen kriminale dhe sfida e komunitetit, shpërndarja e burimeve për zbatim të strategjive</p>	Formale / Vullnetare
Viktoria, Australia	<p>Grupet rajonale për parandalim të krimit</p> <p>Ueb-faqja: http://ëëë.crimeprevention.vic.gov.au/</p>	<p>Policia e Viktorias, departamentet kyçe qeveritare dhe këshillat gjyqësore, Komitetet rajonale këshilluese aborixhine të Drejtësisë (KKRAD), diversiteti kulturor dhe gjuhësor, shërbime të komunitetit, shërbime dhe agjenci rinore, dhuna në familje, sulmet seksuale, shëndetësia në bashkësi, viktimat, banimi dhe shërbimet për të pastrehët, Komitetet për Siguri në Bashkësi, shoqatat e biznesit.</p>	<p>Zhvillimi i njohurive, forcimi i partneritetit, zbatimi i zgjidhjeve të tilla si përmirësimi i infrastrukturës së sigurisë publike, parandalimi i mbishkrimeve, programe të arsimit</p>	Joformale (Departamenti i Drejtësisë ndan grante grupeve të komunitet)

Bjelovar, Vukovar, Varaždin, Čakovec, Međimurje County Croatia	Mbështetja e policimit në bashkësi/Projekti për sigurinë në bashkësi Community Policing Support/Safe Communities Project	Këshilli për parandalimin e krimit në komunitet, Agjencia për zhvillim, qeverisje lokale, policia në bashkësi, OJQ-të dhe qytetarët	Rritja e sigurisë në bashkësi, angazhimin qytetar, përmirësimi i infrastrukturës së sigurisë, rritja e vetëdijesimit përmes fushatave informuese	Mbështetj e zyrtare prej UNDP
	website: http://www.undp.hr/ shoë.jsp?page=862 38			
